



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 172/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, paraqitur kundër Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së posterit në shenjat e komunikacionit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 09.10.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizje Vetëvendosje (LVV), dega në Dardanë, kështu që Partia Demokratike e Kosovës (PDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 5200 (pesëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 06.10.2013, nga LVV, me të cilën pretendohet se anëtarë të subjektit politik PDK, më datën 06.10.2013, në orën 00:45, në Dardanë kanë vendosur njoftimin (materialin zgjedhor) në shenjë e komunikacionit, me të cilin veprim kanë bërë shkeljen nenit 33 pika b) e LZP-së dhe Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike dhe Mbështetësit e tyre (neni 3 pika b). Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur tri fotografi si dëshmi për shkeljen e supozuar.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 07.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 08.10.2013, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.172/2, PZAP-mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK, në të cilën theksohet se pretendimet e LVV janë të trilluara dhe konsiderojmë se janë të pabazuara lidhur me shkeljen e Kodit të Mirësjelljes dhe të LZP-së.

PDK shtoi se fotot e deponuara si provë nuk janë dëshmi e mjaftueshme dhe nuk mund të konsiderohen si prova. Ato janë të fabrikuara dhe të montuara, pasi që siç thanë jemi të vetëdijshëm për respektimin e Kodit të Etikës dhe Rregullës Zgjedhore nr. 11 /2013. Asnjë veprim i tillë nuk është bërë nga aktivistët e PDK-së dhe se për këto veprime nuk mbajmë përgjegjësi.

PDK kërkoi nga PZAP-i që ta hedhë poshtë këtë pretendim të Lëvizjes Vetëvendosje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se materiali zgjedhor “njoftimi” nga radhët e PDK-së është e vendosur në shenjën e komunikacionit, e që është në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe neni 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë godinave dhe objekteve publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj, duke marr parasysh se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 3.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, ngase nga dëshmitë që gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimi nga radhët e PDK-së është vendosur në shenjën e komunikacionit, si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, Rregulla nr.1 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika (c) si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës në Prishtinë**

Anr. 172/2013 më datën 09.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*